



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 188/ Prot.

Tiranë, më 26.01.2026

VENDIM

Nr. 13, Datë 15.01.2026

**“PËR CAKTIMIN E PÛRKOHSHËM TË PROKURORIT ELIDJANA KASA SI
PROKUROR NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË APELIT TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

1. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Erind GERMENJI	Zv/kryetar
3. Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zeqir HODA	Anëtar
5. Arta MANDRO	Anëtar
6. Ledina RIZA	Anëtar
7. Moisi DUDA	Anëtar
8. Vatë STAKA	Anëtar
9. Olger EMINAJ	Anëtar
10. Erind MERKURI	Anëtar
11. Erion FEJZULLA	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15.01.2026, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 18 e vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

**“Për caktimin e përkohshëm të prokurorit Elidjana Kasa si prokuror në Prokurorinë
pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”**

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 188 prot., datë 15.01.2026, të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, dëgjoi Relatorin, znj. Ledina Riza, si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë *(në vijim Këshilli)*, ndër të tjera, garanton karrierën e prokurorëve si pjesë e statusit të magjistratit të njohur nga ligji.
2. Si rezultat i procesit të rivlerësimit kalimtar dhe krijimit të pozicioneve vakante në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me qendër në Tiranë, fillimisht, me Vendimin nr. 334, datë 25.10.2021, Këshilli caktoi përkohësisht prokurorin Elidjana Kasa, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Pukë *(aktualisht, prokurorja Elidjana Kasa është transferuar me detyrë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër)*, si prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
3. Lidhur me caktimin e përkohshëm, në nenin 59, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar *(në vijim, Ligji për Statusin)*, ku thuhet se:

"1. Pozicioni i magjistratit mund të plotësohet përkohësisht, kur magjistrati me pozicion të përhershëm nuk është në gjendje të ushtrojë funksionin për një periudhë jo më shumë se tre muaj, për shkak të:

- a) caktimit në pozicione të tjera;*
- b) arsyeve të tjera të parashikuara nga ligji...."*

4. Ndërsa, sipas nenit 3, pikat 1 dhe 2, të Vendimit nr. 64, datë 15.04.20199 "Për miratimin e Rregullores "Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve", i ndryshuar *(në vijim, Rregullorja)*, të Këshillit, e ndryshuar, parashikohet se:

*"1. Prokurori mund të caktohet përkohësisht në çdo pozicion të të njëjtit nivel ose të një niveli tjetër, për të cilin përmbush kërkesat dhe kriteret e parashikuara në ligj për këtë nivel apo pozicion, në të njëjtën prokurori ku ushtron funksionin ose në një prokurori tjetër.
2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë respekton për aq sa është e mundur vullnetin e prokurorëve gjatë caktimit të përkohshëm."*

5. Në vijim, prokurori Elidjana Kasa është caktuar përkohësisht në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, respektivisht, me Vendimin nr. 12, datë 24.01.2022, Vendimin nr. 71, datë 22.04.2022, Vendimin nr. 193, datë 12.07.2022, Vendimin nr. 259, datë 11.10.2022, Vendimin nr. 16, datë 16.01.2023, Vendimin nr. 80, datë 24.04.2023, Vendimin nr. 287, datë 17.07.2023, Vendimin nr. 320, datë 20.10.2023, Vendimin nr. 3, datë 24.01.2024, Vendimin nr. 53, datë 24.04.2024, Vendimin nr. 149, datë 23.07.2024, Vendimin nr. 220, datë 23.10.2024, Vendimin nr. 9, datë 16.01.2025, Vendimin nr. 79, datë 24.04.2025 dhe me Vendimin nr. 166, datë 11.07.2025, të Këshillit.
6. Së fundi, me Vendimin nr. 313, datë 16.10.2025, "Për caktimin e përkohshëm të prokurores Elidjana Kasa si prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të

Përgjithshëm”, Këshilli ka vendosur caktimin e përkohshëm të prokurorit, vendim i cili mbulon periudhën 25.10.2025 – 25.01.2026.

7. Duke patur parasysh situatën e krijuar për shkak të vakancave në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe faktin se rrethanat mbi bazën e të cilave Këshilli ka vendosur caktimin e përkohshëm të këtij prokurori nuk kanë ndryshuar, Komisioni vlerëson se, prokurori Elidjana Kasa plotëson kushtet për të vazhduar të caktohet përkohësisht në këtë zyrë të prokurorisë.
8. Përsa i takon procedurës për caktimin e përkohshëm, referuar nenit 4, të Rregullores, Komisioni verifikon për çdo kandidat të propozuar, faktin nëse ka një masë disiplinore në fuqi, nëse ndaj tij/saj ka filluar procedimi penal si dhe nëse i plotëson kriteret e përcaktuara nga ligji për atë pozicion.
9. Pas verifikimeve të kryera rezultoi se, prokurori Elidjana Kasa nuk ka masë disiplinore në fuqi si dhe plotëson kushtet e tjera parashikuara në ligj për t’u caktuar përkohësisht si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
10. Sipas nenit 59, pika 4, të Ligjit për Statusin dhe nenit 5, pika 1, të kësaj Rregulloreje, vendimi i Këshillit për caktimin e përkohshëm përmban datën e fillimit dhe të mbarimit të caktimit. Duke qënë se, periodha e caktimit të përkohshëm të prokurorit Elidjana Kasa në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm plotësohet në datë 25.01.2026, atëherë periodha vijuese e caktimit do të shtrihet në periudhën 26.01.2026 – 26.04.2026.
11. Përsa i takon trajtimit financiar gjatë periudhës së caktimit të përkohshëm, prokurori Elidjana Kasa do të trajtohet në përputhje me sa parashikohet në Vendimin nr. 386, datë 30.11.2023, *“Për miratimin e Rregullores “Për caktimin e procedurës dhe masës së trajtimit financiar të prokurorit për shërbimin në skemën e delegimit, për transferimin e përkohshëm, për caktimin e përkohshëm dhe caktimin për një cështje të veçantë”, të Këshillit.*
12. Bazuar në sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozoi Këshillit, caktimin e përkohshëm të prokurorit Elidjana Kasa si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për periudhën 26.01.2026 – 26.04.2026.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 149, pika 1 dhe 149/a, pika 1, germa “a”, të Kushtetutës, në nenin 59, pikat 1 dhe 4, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164, pika 8, 166, pika 2, 189, pika 1, germa “a”, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenet 3, pikat 1-2, 4 dhe 5, pika 1, të Vendimit nr. 64, datë 15.04.2019 “Rregullore “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve”, i ndryshuar, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Caktimin e përkohshëm të prokurorit Elidjana Kasa, aktualisht, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
2. Prokurori Elidjana Kasa do të ushtrojë funksionin e prokurorit në pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për periudhën 26.01.2026 – 26.04.2026.
3. Trajtimi financiar i prokurorit Elidjana Kasa në periudhën sipas pikës 2 do të kryhet në përputhje me Vendimin nr. 386, datë 30.11.2023, "Për miratimin e Rregullores "Për caktimin e procedurës dhe masës së trajtimit financiar të prokurorit për shërbimin në skemën e delegimit, për transferimin e përkohshëm, për caktimin e përkohshëm dhe caktimin për një çështje të vecantë", të Këshillit.
4. Ky vendim i njoftohet Prokurorit të Përgjithshëm, Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër dhe prokurorit Elidjana Kasa.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë sot më 15.01.2026.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR

Mirela Bogdani

ZV/KRYETAR

Erind Gërmenji

ANËTAR

Sokol Stojani

ANËTAR

Zeqir Hoda

ANËTAR

Arta Mandro

ANËTAR

Ledina Riza

ANËTAR

Moisi Duda

ANËTAR

Vatë Staka

ANËTAR

Olger Eminaj

ANËTAR

Erind Merkuri

ANËTAR

Erion Fejzulla